

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeministri Rama nga New York: Joe Biden e ka tradhtuar Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të! S'duhej lejuar që ajo farsë të fillonte - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/kryeministri-rama-nga-new-york-joe-biden-e-ka-tradhtuar-hash-im-thacin-shba-nuk-beri-me-te-miren-per-te-sduhej-lejuar-qe-ajo-farse-te-fillonte#872612
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:14:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:08:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b8a010344a93862f282eb5f69cfa81e8f47cc40e3d753711df52ee830161e4b7
TEKSTI	2c3c1b061d04a56d0394d9742150a8bcaa842c15246adb1638ec3e26070447c6
PAMJA	ad083f828fd77c3a1e5a4eab335d70805c284bc838f82e9df552484d0c25bdb4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c10eccd29afa60f89f8bf6b5f91cea48ccb5b00c04a870d14d039b83d37a1c07
E MËPARSHMJA	bb871a12b2ee4a695ba0557f9efffb65cc1e89c6b29e9daaad5d19fa2ed3cd1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c10eccd29afa60f89f8bf6b5f91cea48ccb5b00c04a870d14d039b83d37a1c07>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Report Tv siguron videon e eliminimit të Tanit të Ruzhdiut në Sarandë! 44-vjeçari ia mbath pasi qëllohet, autori me skafander i vihet pas dhe i shkrepi armën në kokë



Politikë

Kryeministri Rama nga New York: Joe Biden e ka tradhtuar Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të! S'duhej lejuar që ajo farsë të fillonte

Kryeministri Edi Rama tha se Qeveria po përpjet që të sjellë miliarda euro investime të huaja në Shqipëri, jo vetëm përmes investimit që Jared Kushner pritet të realizojë në ishullin e Sazanit, por edhe përmes investitorëve të tjerë të huaj që duan të bëjnë biznes në vendin tonë.

■ 'Jo vetëm projekti i famshëm i Kushner', Rama: Po përgatitemi të sjellim miliarda euro investime në Shqipëri

■ Rama: SHBA dhe Europa s'kanë qenë kurrë më në ndasi sesa sot!

■ 'Dikur korrupsioni ishte kudo', Rama: Sistemi demokratik i Shqipërisë po ndërton imunitetin e vet



Redaksia

25 Shtator, 16:07 | Përditësimi: 25 Shtator, 17:08

f Share Tweet

A A

Kryeministri [Edi Rama](#) deklaroi se ish-Presidenti amerikan Joe Biden e ka tradhtuar Hashim Thaçin, i cili u dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara për Kosovën në Hagë.

Gjatë fjalës së tij në një takim në New York, në mbrëmjen gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane, Rama tha se [SHBA](#) duhet të bënte më shumë për 4 ish-krerët e [UÇK](#)-së, të dënuar me 81 vite në total nga Haga.

Duke e cilësuar 'farsë' procesin në Dhomat e Specializuara në Hagë, kryeministri Rama tha se SHBA s'duhet të kishte lejuar që Gjykata Speciale të ishte krijuar që në fillim.



LEXO EDHE:

U sulmua me vezë nga protestues në New York, reagon Rama: Flamurin kombëtar e kam ngritur më lart se kurrë, asgjë s'më ndal për ta çuar në majën e BE

"Më lejoni të them disa fjalë pa mbajtur një fjalë tjetër të gjatë. Dua së pari të falënderoj Ilirin dhe Martinin për këtë ftesë bujare. I kërkoj ndjesë gjithëkujt që ndoshta do ndihet disa i shpërfillur, por mund të them se gjëja më e mirë që mund të më ndodhte sot, është të isha ulur krah kumbarit të komunitetit shqiptar, zotit Sal Rusi. Meqë ra fjala për Sal Rusin dhe familjen e tij, më bën të vuaj mungesën e dikujt që ka qenë gjithmonë i ftuar në strehën e tij, ai është në strehën e tij.

Ai është [Hashim Thaçi](#), ai nuk është me ne këtu, sepse ky vend e tradhtoi. Sepse Joe Biden që e emërtoi Xhorxh Uashingtonin e Kosovës, e tradhtoi. Edhe pse Gjenerali Klark dhe disa njerëz bënë më të mirën, ky vend nuk bëri më të mirën për Hashim Thaçin. Kur them tradhtuar, është sepse ne si vend i vogël ndihemi miq me SHBA-të, më të mëdhenjtë e më të fortët. Mund të ishte bërë më shumë, duke mos lejuar që kjo farsë të niste. Gjeneral, ju jam mirënjohës për gjithçka keni bërë në kapacitetin tuaj personal", shtoi Rama.

Kryeministri foli edhe për investimet e huaja në vend dhe tha se Qeveria po punon për të sjellë miliarda euro në Shqipëri, jo vetëm përmes projektit që dhëndri i Presidentit [Donald Trump](#) pritet të ndërtojë në ishullin e Sazanit, por edhe përmes investimeve të tjera.

"Po përgatitemi që të hedhim në vend miliarda, jo vetëm me projektin e famshëm dhe të jashtëzakonshëm të Kushner, por edhe me projekte të tjera të mëdha. Në Shqipëri gjërat janë shumë të qarta", theksoi Rama.

Rama foli edhe për ndrvshimin e rrëniësishëm të Shqipërisë vitet e fundit duke vecuar in vetëm



zhvillimin ekonomik të vendit por edhe forcimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit.



"Ne shqiptarët, ajo që ne e shohim si problem, partnerët europianë e shohin si sukses .Pyetja është a mund të ketë një vend më shumë korrupsion nëse ai luftohet çdo ditë. A është e vërtetë që në një vend ku korrupsioni është gjithkund, lufta kundër tij të ndodhë çdo ditë? Jo nuk është. Dikur në Shqipëri, korrupsioni ishte gjithkund dhe lufta askund. Sot shohim diçka ndryshe", tha Rama.

Kujtojmë se kryeministri Edi Rama ndodhet në New York të Shteteve të Bashkuara për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 16:28

Rama nga New York: SHBA dhe Europa s'kanë qenë kurrë më në ndasi sesa sot!



Kryeministri Edi Rama u shpreh gjatë fjalës së tij në një takim në New York të Shteteve të Bashkuara, se sot SHBA dhe shtetet europiane janë më të ndara se kurrë më parë.




"Duke e përmbyllur fjalën time, do të doja të thoja diçka tjetër, sepse Martini kaloi nga një pjesë, paqe, paqe, paqe, nga Shqipëria në Kosovë, në komunitetin shqiptar të Maqedonisë së Veriut dhe tha të ndarë, të ndarë, të ndarë. A mos Amerika e bashkuar Martin? A mos është Europa e bashkuar? A njeh ndonjë vend demokratik të bashkuar sot? S'kanë qenë kurrë më në ndasi. S'e kam parë kurrë më të ndarë Francën, Gjermaninë dhe SHBA-të. Në ndasi kemi qenë më të mirët, por tashmë nuk jemi më vetëm, jemi në një klub të madh. Të gjithë janë të ndarë. Ka edhe më keq, të rinjtë tanë janë edhe më në ndasi sesa vendet tona", tha mes të tjerash Rama.

R.Xh/Shqiptarja.com

[f Share](#)

Ora 16:26

'Jo vetëm projekti i famshëm i Kushner'- Rama nga New York: Po përgatitemi të sjellim miliarda euro investime në Shqipëri



Kryeministri Edi Rama tha gjatë fjalës së tij në mbrëmjen gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane në New York se Qeveria po përpaketon që të sjellë në Shqipëri investitorë të fuqishëm të huaj, që do të hedhin miliarda euro.

Rama tha se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për projektin që dhëndri i Presidentit Donald Trump, [Jared Kushner](#), pritët të ndërtojë në ishullin e Sazanit, por edhe për një sërë projektesh të tjera.

Duke cituar shprehjen 'Shqipëria është e shqiptarëve', kryeministri Rama tha se ky është një slogan i turpshëm, pasi sipas tij, shumë shqiptarë kanë qenë vetë emigrantë në shtete të tjera. Pra sipas Ramës, 'nëse Italia do të ishte e italianëve', shumë shqiptarë që kanë emigruar dhe shkëlqyer në Itali, nuk do e kishin këtë mundësi.



"Po përgatitemi që të hedhim në vend miliarda, jo vetëm me projektin e famshëm dhe të jashtëzakonshëm të Kushner, por edhe me projekte të tjera të mëdha. Në Shqipëri gjërat janë shumë të çarta. Dasi kemi kaluar një epokë pasqyrimi, ku kushdo që donte të ftohtë


janë shumë të qarta. I ashpër kam kurrë një epokë posteterrme, ka kështu që vëmë re momentet e ndonjë palë zgjedhje në ndonjë vend evropian e kishte të lehtë, duke treguar shqiptarët si delja e zezë. Na duhet të bëjmë shumë më tepër me më shumë kurajo, pa përjashtuar në një betejë të pakuptimtë ideologjike, zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe pa fajësuar të huajt që po vijnë e po na marrin tokën. Gjatë muajve të fundit kam dëgjuar sloganin më të neveritshëm dhe më të turpshëm, 'Shqipëria u përket shqiptarëve'. Por nëse do të kishte qenë e njëjta gjë për të gjitha vendet ku shkuan dhe lulëzuan shqiptarët, ne s'do të kishim bërë asgjë. Shqipëria i përket Zotit dhe mikut, ashtu si shtëpia e shqiptarit i përket Zotit dhe mikut", tha kryeministri Rama.

R.Xh/Shqiptarja.com

f Share

Ora 16:20

'Armia nuk na sulmojnë me raketa, por përmes rrjeteve sociale', Rama në New York: E vërteta nuk ka qenë kurrë më e abuzuar



Pjesën e fundit të fjalimit të tij në mbrëmjen gala të Këshillit të Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane në Nju Jork, Rama ia kushtoi ndikimit të rrjeteve sociale, dezinformimit dhe përçarjes në shoqëri. Kryeministri tha se sot kërcënimet nuk vijnë vetëm nga armët, por edhe nga mënyra se si, sipas tij, manipulohet opinioni publik dhe ndikohen të rinjtë përmes platformave sociale.

Në vijim, Rama tha se përçarjet nuk janë problem vetëm i Shqipërisë, por edhe i vendeve të mëdha, të cilat, sipas tij, po kalojnë një periudhë polarizimi. Ai shtoi se shqiptarët nuk mund t'i zgjidhin të vetëm këto sfida globale, ndërsa e mbylli fjalën me batutën se "edhe kur bota të bjerë në kolaps dhe njerëzimi të marrë fund, do të mbijetojë një shqiptar që do të thotë: 'Ju thamë'".




"Armia që e vendeve tona nuk kanë nevojë të na ndjekin me raketa. Na sulmojnë duke u përzier me trurin e të rinjve tanë cdo orë përmes rrjeteve sociale dhe telefonit. Zoti e bekoftë Amendantin e Parë por nëse ai lejon cdo lloj mbeturine e plehre, nuk po jetojmë më në civilizimin ku arsimi më i mirë, sjellja më e mirë dhe komunikimi është zhvilluar. Po jetojmë barbarinë. Armia që tanë kanë vënë mburojë për njerëzit e tyre. Nuk jam avokat për mbylljen e medias sociale apo për lirinë e shprehjes. Ajo për të cilën avokatoj është se e vërteta kurrë nuk ka qenë më e shpërfillur, më e abuzuar, më e konsumuar në emër të gënjeshtërës, manipulimit dhe të së keqes. Ndaj më lini të përfundoj se po jemi të ndarë, por këto ndasi na dëmtojnë vetëm ne dhe ne shqiptarët jemi rritur duke dëmtuar veten për shekuj. Ka një tjetër ndasi që po dëmton botën dhe ndasia në vendet e mëdha që supozohet të na tregojnë rrugën e të mbajnë pishtarin ndezur. U takon atyre të zgjedhin se çfarë duan të bëjnë por si shqiptarë, le të mos tallemi me veten dhe të themi që kjo është diçka që mund ta zgjidhim të vetëm. Ne shqiptarët do të mbetemi shqiptarë, e kur bota të bjerë në kollaps, e njerëzimi të marrë fund do të jetë një shqiptar gjallë që do jetë dëshmitar e do thotë 'ju thamë!' tha Rama

U.D/Shqiptarja.com

f Share

Ora 16:10

"Dikur korrupsioni ishte kudo, sot luftohet çdo ditë", Rama në New York: Sistemi demokratik i Shqipërisë po ndërton imunitetin e vet



Gjatë fjalimit të tij në mbrëmjen gala të Këshillit të Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane në Nju Jork të

SHBA-se, kryeministri Rama roli për ndryshimin e rrejtësisë në Shqipëri vitet e fundit, duke veçuar jo vetëm zhvillimin ekonomik të vendit por edhe forcimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit.



"Sa shumë ka ndryshuar Shqipëria gjatë këtyre viteve. Askush nuk ta fal suksesin. Po, është viti i pestë a i gjashtë, që kemi aeroportin më të madh në rajon. Duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative që është aeroporti me rritjen më të madhe në Europë, por edhe me shifra absolute, me shumë udhëtar se aeroporti i Beogradit. Do të vazhdojë sepse është vetëm fillimi.

Nuk është shumë e thjeshtë që ta përtypin të gjithë se kush është Shqipëria, të jetë e aftë të rritet dhe të tregojë këtë kapacitet për ndryshim. Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu. Jo se nuk kemi mangësi apo probleme. Martini nuk harroi të përmendte korrupsionin. Ne shqiptarët, ajo që ne e shohim si problem, partnerët europianë e shohin si sukses. Pyetja është a mund të ketë një vend më shumë korrupsion nëse ai luftohet edhe ditë. A është e vërtetë që në një vend ku korrupsioni është gjithkund, lufta kundër tij të ndodhë edhe ditë? Jo nuk është. Dikur në Shqipëri, korrupsioni ishte gjithkund dhe lufta askund. Sot shohim diçka ndryshe. E shohim sepse sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitetin e vet.

Është fjala për një sistem pushtetesh të pavarura që funksionojnë me gjithë defektet, problemet dhe nevojën për tu rritur, por sidoqoftë duke shfaqur çdo ditë faktin që ky nuk është vendi ku mund të ecësh dora dorës me korrupsionin pa asnjë pasojë. Ky është sukses i madh për një vend ku 10 vjet më parë, kafshët dhe shpendët masakroheshin nga mijëra gjuetarë europianë që kalonin në kufirin tonë, që të bënin festë pa rregulla e kontrole, të vrisnin majtas dhe djathtas duke lënë pirgje zogsh të ngordhur. Sot vendi proteston për bio diversitetin, vetëm 10 vjet më vonë, pasi ndaluan gjuetinë, rritëm zonat e mbrojtura dhe pasi ndaluan shfrytëzimin e pyjeve, rritëm 3 fish numrin e shpendëve dhe kafshëve, rritëm shumëfish si kurrë më parë, sipërfaqen e pyjeve të rikuperuara. Tashmë kemi një Shqipëri të re. Njerëzit duan më shumë. Shqipëria ku njerëzit jetonin me idenë se vendi mund të jetë më keq nuk ekziston më" tha Rama,

U.D/Shqiptarja.com

Share

R.Xh/E.H/Shqiptarja.com

TAG: [edi rama](#) [SHBA](#) [kosove](#) [hashim thaci](#) [uck](#) [Jared Kushner](#) [donald trump](#) [Jakup Krasniqi](#) [rexhep selimi](#)

kadri veseli

Sa e vlerësoni këtë artikull?



3.0 / 5 (4 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

tironsi:

25/09/2026 16:21

po mer plak po ti je si ajo kurva qe skon nga te fryj era me zevendsin e joe Biden tonin bone salen non grata tashi ktheve nga trapi se do investoj ne zverneç,,

Përgjigju

Lenci:

25/09/2026 17:28

Shoku kur nuk merr vesh nga politika mos shkruaj kot. Ate mhb me joe Biden ai e ka si kunje kundra partisë demokratike të USA. Sponsorizimi me i madh i protestave të flamingove sot vjen nga partia e Joe Biden për të goditur Trumpin, sidomos kohet e fundit nga që janë zgjedhjet midterm në Amerikë. Secili në fundit të fundit shikon të pasmet e veta. Partia e Joe Biden shikon interesin e vet, edhe gjatë shikon interesin e vet sepse sponsorizimet e tyre godasin edhe atë..



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera



Rama nga New York:



'Jo vetëm projekti i



'Armia nuk na sulmoinë

SHBA dhe Europa s'kanë
qenë kurrë më në ndasi
sesa sot!

25 Shtator, 16:28



"Dikur korrupsioni ishte
kudo, sot luftohet çdo
ditë", Rama në New York:

famshëm i Kushner'-
Rama nga New York: Po
përgatitemi të sjellim
miliarda euro investime
në Shqipëri

25 Shtator, 16:26



Arresti i ish-kreut të
SHISH, të hënën mblidhet
Këshilli i Sigurisë

me raketa, por përmes
rrjeteve sociale', Rama në
New York: E vërteta nuk
ka qenë kurrë më e
abuzuar

25 Shtator, 16:20



Von der Leyen nis
turneun në Ballkan, të
mërkurën vjen në

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.